



(Mos)kushtëzimi i dënimit me kusht

Analizë e zbatimit të detyrimeve specifike në dënimet me kusht



Autor: Gzim Shala

Me kontribut të veçantë të: Anesa Hoxha

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e National Endowment for Democracy dhe Rockefeller Brothers Fund (RBF).

Implementuar nga:



Përkrahur nga:



Rreth IKD:

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jofitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorinë e drejtësisë.

IKD, Rr. Ilaz Agushi

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Shtator, 2026

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive	7
2.	Metodologjia	9
3.	Dënimi me kusht	10
4.	Fuqizimi i dënimit me kusht përmes detyrimeve specifike	12
5.	Niveli i aplikimit të detyrimeve me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht.....	15
6.	Aplikimi sipas llojit të detyrimit	16
7.	Aplikimi sipas llojit të veprës penale.....	18
8.	Mosarsyetime lidhur me mosaktimin e detyrimit	19
9.	Mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues.....	20
10.	Pasojat e mosshqiptimit të obligimeve	21
a.	Qëllimi i dënimit	21
b.	Formalizimi i dënimit	22
c.	Kushti “pa kushte”	23
11.	Dënimi më i lartë se kushtëzimi.....	23
12.	Recidivizmi	24
13.	Përfundimet nga fokus grupi.....	27
14.	Përfundime	30
15.	Rekomandime	31
Aneks 1: Aplikimi i detyrimeve sipas kategorisë dhe veprës penale.....		32

1. Përmbledhje ekzekutive

Dënimi me kusht është dënim alternativ, përmes të cilit gjykata e shpall personin fajtor dhe ia cakton dënimin, por e pezullon ekzekutimin e tij. Kjo mundësi kushtëzohet me moskryerjen e një veprë tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit dhe përmbushjen e detyrimeve që gjykata mund t'ia caktojë të dënuarit. Qëllimi është që kryerësi të rehabilitohet dhe të parandalohet nga kryerja e veprave të reja penale, pa qenë e nevojshme ta vuajë dënimin në burg. Megjithatë, shqiptimi i këtij dënimi kërkon që gjykata të vlerësojë rrethanat e rastit, sjelljen e kryerësit dhe nëse qëllimi i dënimit mund të arrihet pa burgim efektiv.

Në këtë drejtim, Kodi Penal nr. 06/L-074 i mundëson gjykatës caktimin e detyrimeve konkrete, si kompensimi i dëmit, kthimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale, trajtimi i varësisë nga alkooli apo droga dhe ndalimi i kontaktit me persona të caktuar. Përmes këtyre detyrimeve synohet të ndikohen shkaqet që kanë çuar në kryerjen e veprës penale, të ndihmohet rehabilitimi i të dënuarit dhe të mbrohen interesat e viktimës. Nevoja për caktimin e tyre duhet të vlerësohet dhe të arsyetohet sipas secilit rast. Nëse gjykata vetëm e cakton dënimin dhe e pezullon ekzekutimin e tij, pa vlerësuar nevojën për detyrime konkrete, dënimi me kusht rrezikon të mbetet kërcënim abstrakt dhe të perceptohet më tepër si amnistim i kryerësit.

Megjithatë, gjetjet tregojnë se Gjykatat, me rastin e shqiptimit të dënimeve me kusht, nuk janë duke shqiptuar në nivel adekuat detyrimet specifike. Gjetjet tregojnë se detyrimet specifike aplikohen jashtëzakonisht rrallë. Nga 300 aktgjykimet e analizuara, vetëm 12 aktgjykime kanë përmbajtur detyrime specifike, ndërsa në total janë evidentuar 17 detyrime të tilla. Kjo tregon se në shumicën dërrmuese të rasteve dënimi me kusht shqiptohet vetëm me përcaktimin e dënimit kryesor dhe periudhës së verifikimit, pa ndonjë detyrim konkret që do të mund të ndikonte në rehabilitimin e të dënuarit, kompensimin e viktimës apo parandalimin e kryerjes së veprave të reja penale.

Raporti gjen se nga 15 detyrimet specifike të parapara me Kodin Penal, në aktgjykimet e analizuara janë aplikuar vetëm gjashtë lloje të tyre. Më së shpeshti janë shqiptuar detyrimet që lidhen me kompensimin apo dëmshpërblimin e viktimës, heqjen dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës, trajtimin mjekësor apo rehabilitues dhe kthimin e dobisë pasurore. Ndërkaq, një pjesë e madhe e detyrimeve të parapara me ligj nuk janë evidentuar fare në praktikën e analizuar.

Një nga gjetjet kryesore të raportit është mungesa e arsyetimit të mjaftueshëm në aktgjykime. Në 288 aktgjykime ku nuk janë shqiptuar detyrime specifike, gjykatat nuk kanë dhënë arsyetim pse në rastin konkret nuk ka pasur vend për shqiptimin e ndonjë detyrimi të tillë. Kjo e bën të vështirë të kuptohet nëse gjykata e ka vlerësuar realisht mundësinë e shqiptimit të detyrimeve specifike, apo nëse dënimi me kusht është shqiptuar në mënyrë rutinore, vetëm përmes periudhës së verifikimit.

Raporti trajton edhe rolin e Shërbimit Sprovues. Nga aktgjykimet e analizuara rezulton se mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues është urdhëruar në 23 raste. Megjithatë, në 18 prej tyre nuk është shqiptuar ndonjë detyrim konkret që do të mbikëqyrej. Kjo krijon paqartësi praktike mbi përmbajtjen reale të mbikëqyrjes dhe mbi efektivitetin e saj, veçanërisht kur aktgjykimi nuk e përcakton qartë rolin e Shërbimit Sprovues dhe detyrimin që duhet të mbikëqyret.

Raporti arrin në përfundimin se dënimi me kusht në praktikën gjyqësore në Kosovë shpesh rrezikon të mbetet një masë formale, nëse nuk shoqërohet me vlerësim konkret të nevojës për detyrime specifike, arsyetim të mjaftueshëm dhe mbikëqyrje efektive. Për këtë arsye, IKD rekomandon që gjykatat ta arsyetojnë në mënyrë më të plotë shqiptimin e dënimit me kusht dhe mosshqiptimin e detyrimeve specifike, prokurorët të jenë më aktivë në propozimin e këtyre detyrimeve, Shërbimi Sprovues të përfshihet qartë në rastet kur kërkohet mbikëqyrje, ndërsa Akademia e Drejtësisë dhe institucionet gjyqësore të trajtojnë këtë çështje përmes trajnimeve, diskutimeve profesionale dhe udhëzimeve praktike.

2. Metodologjia

Ky raport bazohet në metodologji të kombinuar të analizës juridike dhe hulumtimit empirik. Për qëllime të hartimit të këtij raporti, fillimisht është analizuar korniza ligjore vendore që rregullon dënimin me kusht dhe detyrimet që mund të caktohen me rastin e shqiptimit të tij. Krahas kësaj, janë analizuar edhe standardet dhe dokumentet ndërkombëtare relevante për masat alternative ndaj burgimit, shërbimin sprovues, sanksionet në komunitet dhe individualizimin e dënimeve alternative.

Pjesa empirike e raportit bazohet në analizimin e 300 aktgjykimeve në të cilat gjykatat kanë shqiptuar dënim me kusht. Aktgjykimet janë marrë nga faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe janë përzgjedhur në mënyrë rastësore. Analiza ka përfshirë aktgjykime të viteve 2023, 2024 dhe 2025, ku për secilin vit janë analizuar rreth 100 aktgjykime. Në këto 300 aktgjykime janë identifikuar gjithsej 320 dënime me kusht, pasi në disa aktgjykime janë evidentuar më shumë se një dënim me kusht.

Mostra është ndarë sipas gjykatave themelore, departamenteve dhe kategorive të veprave penale. Nga Gjykata Themelore në Prishtinë janë analizuar 60 aktgjykime, ndërsa nga Gjykatat Themelore në Mitrovicë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Gjilan dhe Pejë janë analizuar nga 40 aktgjykime. Sa i përket llojit të veprave penale, mostra ka përfshirë aktgjykime për veprat penale kundër pasurisë, veprat penale të narkotikëve, veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme, korrupsionin zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare, veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik, veprat penale kundër jetës dhe trupit dhe veprat penale të armëve.

Të dhënat e gjeneruara nga këto aktgjykime janë përpunuar në mënyrë kuantitative dhe kualitative, me qëllim të evidentimit të nivelit real të aplikimit të detyrimeve specifike dhe mënyrës se si gjykatat e arsyetojnë këtë çështje. Kështu, gjetjet e raportit janë empirike dhe burojnë nga analizimi i aktgjykimeve të përfshira në mostrën si më lartë. Përpunimi i të dhënave është bërë përmes krahasimit të rezultateve sipas gjykatave, departamenteve, viteve, kategorive të veprave penale dhe llojeve të detyrimeve. Kjo ka mundësuar që raporti të mos kufizohet vetëm në analizë formale të dispozitave ligjore, por të pasqyrojë edhe mënyrën konkrete se si dënimi me kusht dhe detyrimet specifike aplikohen në praktikën gjyqësore.

Përveç analizimit të aplikimit të detyrimeve specifike, IKD ka shqyrtuar edhe nëse në aktgjykimet e përfshira në mostër evidentohet e kaluara penale e të dënuarit. Ky evidentim është bërë vetëm mbi bazën e përmbajtjes së aktgjykimit, pa kërkime apo verifikime të jashtme.

Pas konsolidimit të gjetjeve fillestare, draft-raporti është ndarë për komente me akterët relevantë të sistemit të drejtësisë dhe institucioneve të tjera relevante. Ky proces ka pasur për qëllim verifikimin, plotësimin dhe diskutimin e gjetjeve të raportit para finalizimit të tij. Komentet dhe të dhënat e pranuar gjatë këtij procesi janë trajtuar dhe adresuar nga IKD.

3. Dënimi me kusht

Dënimi me kusht është sanksion penal dhe, më konkretisht, një formë e dënimit alternativ. Shqiptimi i tij nënkupton se gjykata e ka shpallur personin fajtor dhe ia ka caktuar dënimin për veprën penale të kryer. Prandaj, ai nuk përbën lirim nga përgjegjësia penale, falje apo mungesë të dënimit. Karakteri alternativ i tij lidhet vetëm me mënyrën e ekzekutimit: dënimi ekziston dhe është caktuar, por ekzekutimi i tij pezullohet për aq kohë sa personi i dënuar i respekton kushtet e vendosura nga gjykata.

Dallimi kryesor ndërmjet dënimit me kusht dhe burgimit efektiv qëndron në faktin se, te burgimi efektiv, personi fillon ta vuajë dënimin dhe privohet nga liria, ndërsa te dënimi me kusht ekzekutimi i burgimit shtyhet gjatë një periudhe verifikuese. Nëse i dënuari kryen vepër të re penale ose nuk i përmbush detyrimet e caktuara, dënimi mund të revokohet dhe të ekzekutohet.

Dënimi me kusht është një prej instrumenteve kryesore përmes të cilit e drejta penale synon të shmangë shqiptimin e panevojshëm të dënimit me burgim efektiv. Ai nuk paraqet mungesë të dënimit. Përkundrazi, gjykata e cakton dënimin, por e pezullon ekzekutimin e tij për një periudhë verifikuese, duke e kushtëzuar këtë pezullim me sjelljen e të dënuarit. Në këtë kuptim, dënimi me kusht përmban kërcënimin e tij real: nëse i dënuari nuk i respekton kushtet e përcaktuara nga gjykata, dënimi specifik do të ekzekutohet.

Standardet ndërkombëtare e trajtojnë dënimin me kusht si pjesë e masave alternative ndaj burgimit. Rregullat e Tokios të Kombeve të Bashkuara theksojnë se masat alternative ndaj dënimit me burgim duhet të promovohen për të mundësuar individualizimin e reagimit penal, duke ruajtur ekuilibrin ndërmjet të drejtave të kryesit, të drejtave të viktimës dhe interesit të shoqërisë¹. Në të njëjtën frymë, UNODC vlerëson se alternativat ndaj burgimit duhet të kuptohen si mjete të politikës penale që synojnë uljen e përdorimit të burgimit, veçanërisht kur qëllimi i dënimit mund të arrihet më mirë në shoqëri sesa në burg.²

Kodi nr.06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës e rregullon dënimin me kusht si dënim alternativ [neni 46]. Sipas këtij Kodi, qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra penale jo të rënda, kur kërcënimi me dënimin kryesor është i mjaftueshëm për ta ndaluar kryesin që të mos kryejë vepër të re penale [neni 47]. Me dënimin me kusht, gjykata ia cakton kryesit dënimin dhe njëkohësisht urdhëron që ai dënim të mos ekzekutohet nëse i dënuari nuk kryen vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit [neni 48]. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit dhe as më e gjatë se pesë vite [neni 48].

Në aspektin formal, Kodi Penal 06/L-074 lejon shqiptimin e dënimit me kusht për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me burgim deri në pesë vite. Për vepra penale për të cilat është

¹ Tokyo Rules, Rules 1.1, 1.4 and 2.3;

² UNODC, *Alternatives to Imprisonment*, 2007, Part I and II.

paraparë dënim deri në dhjetë vite, dënimi me kusht mund të shqiptohet vetëm nëse zbatohen dispozitat për zbutjen e dënimit [neni 49]. Edhe në këto raste, dënimi me kusht mund të shqiptohet vetëm kur gjykata shqipton dënim me gjobë ose dënim me burgim deri në dy vite [neni 49].

Megjithatë, plotësimi i këtyre kushteve nuk nënkupton se dënimi me kusht duhet të shqiptohet automatikisht. Këto janë vetëm kufijtë formalë brenda të cilëve gjykata mund ta shqyrtojë këtë alternativë. Kodi Penal 06/L-074 kërkon që gjykata të marrë parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera të kryerjes së veprës [neni 49]. Në këtë kuptim, dënimi me kusht duhet të jetë rezultat i një vlerësimi specifik, rast pas rasti, dhe jo thjesht një dënim që mund të shihet si amnistim i kryerësit nga dënimi kryesor.

Kjo qasje lidhet edhe me qëllimet e përgjithshme të dënimit. Kodi Penal 06/L-074 përcakton se dënimi synon parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, kompensimin e viktimave ose komunitetit dhe shprehjen e gjykimit shoqëror ndaj veprës penale [neni 38]. Për këtë arsye, dënimi me kusht është i arsyeshëm vetëm kur këto qëllime mund të arrihen pa ekzekutimin e dënimit me burgim.

Raporti i Komisionit për Reformë Ligjore të Irlandës për dënimet e pezulluara e trajton këtë masë si të pajtueshme me qëllimet e ndëshkimit, përfshirë ndëshkimin, parandalimin dhe rehabilitimin. Por, i njëjti raport thekson se shmangia e burgimit nuk duhet të shihet e izoluar dhe gjithmonë duhet të balancohet me faktorët që mund ta arsyetojnë burgimin efektiv.³ Kjo është e rëndësishme edhe për Kosovën: dënimi me kusht nuk duhet të përdoret për ta zëvendësuar analizimin e rrezikut specifik, dëmit, fajësisë dhe nevojës për parandalim.

Në praktikë, dënimi me kusht mund të jetë i përshtatshëm në rastet kur vepra penale është më e lehtë, kryesi nuk ka histori relevante penale, ka treguar sjellje pozitive pas kryerjes së veprës, ka shprehur pendim, ka kompensuar dëmin ose ka treguar gatishmëri për kompensim, dhe kur mund të parandalohet recidivizmi.

Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës i jep gjykatës mundësi që vendimmarrjen për dënim ta bazojë në informacion më të plotë. Pas pranimit të fajësisë ose pas aktgjykimit dënues, gjykata mund të mbajë seancë për caktimin e dënimit, ku palët mund të paraqesin rrethana rënduese, lehtësuese dhe çështje të tjera relevante për dënimin [neni 356]. Po ashtu, gjykata mund të kërkojë nga Shërbimi Sprovues raport para shqiptimit të dënimit [neni 356]. Aktgjykimi me shkrim duhet të përmbajë edhe arsyetimin [neni 369]. Këto dispozita e bëjnë të qartë se dënimi me kusht duhet të jetë vendim i arsyetuar dhe i individualizuar.

³ Laë Reform Commission of Ireland, *Suspended Sentences*, 2020, Recs. 3.01, 3.02 and 4.01.

4. Fuqizimi i dënimit me kusht përmes detyrimeve specifike

Dënimi me kusht e arrin funksionin e tij vetëm kur nuk mbetet thjesht si dënim formal. Nëse gjykata vetëm e cakton dënimin dhe e pezullon ekzekutimin e tij, pa vlerësuar nevojën për detyrime konkrete, atëherë dënimi me kusht rrezikon të mbetet kërcënim abstrakt. Si i tillë, ky dënim rrezikon mos të arrijë qëllimin e dënimit, por të perceptohet më tepër si amnistim ligjor i kryerësve të veprave penale.

Detyrimet specifike janë mjet përmes të cilit dënimi me kusht lidhet me veprën, me rrezikun, me nevojat e kryesit, me interesin e viktimës dhe me parandalimin e veprave të reja penale. Këto detyrime shërbejnë për ta kthyer dënimin me kusht nga një masë formale e pezullimit të dënimit në një instrument konkret kontrolli, rehabilitimi, kompensimi dhe parandalimi. E gjithë kjo, pa shqiptuar dënim me burgim efektiv.

Kodi Penal 06/L-074 parasheh disa mundësi në këtë drejtim. Së pari, kur shqipton dënim me kusht, gjykata mund të urdhërojë që dënimi të ekzekutohet nëse i dënuari në afatin e caktuar nuk e kthen dobinë pasurore të fituar me vepër penale, nuk e kompenson dëmin e shkaktuar ose nuk përmbush detyrime të tjera të parapara me këtë Kod [neni 48]. Së dyti, gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues [neni 54]. Së treti, gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues [neni 55].

Në rastet e varësisë nga droga ose alkooli, Kodi Penal 06/L-074 lejon shqiptimin e dënimit me kusht me trajtim të detyrueshëm rehabilitues, nëse gjykata, pas shqyrtimit të raportit të Shërbimit Sprovues, vlerëson se varësia ka qenë faktor kryesor i kryerjes së veprës dhe se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun e kryerjes së veprës së re penale [neni 54]. Kjo dispozitë tregon se detyrimi nuk është vetëm masë shtesë, por adresim i shkakut që ka sjellë deri tek vepra penale.

Në rastet kur integrimi i të dënuarit në shoqëri ose përmbushja e kushteve të shqiptuara arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes, gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues [neni 55]. Në këtë rast, gjykata e urdhëron të dënuarin të mbajë kontakt me Shërbimin Sprovues dhe mund të caktojë një ose më shumë detyrime nga lista e Kodit Penal [neni 55 dhe 56]. Me rastin e caktimit të këtyre detyrimeve, gjykata duhet të marrë parasysh moshën, gjendjen shëndetësore dhe mendore, mënyrën e jetesës, nevojat familjare, shkollore dhe të punës, motivet e kryerjes së veprës, sjelljen pas veprës, sjelljen e mëparshme dhe rrethanat personale e familjare [neni 55].

Lista e detyrimeve të Kodit Penal 06/L-074 [neni 56] është e gjerë. Specifikisht, lista nga neni 56 i këtij Kodi përmban gjithsej 15 lloje të detyrimeve të cilat mund të shqiptohen nga gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim. Kjo listë përfshinë mjekimin ose rehabilitimin në institucion shëndetësor, programin mjekësor ose rehabilitues, vizitat te psikologu ose këshilluesit, aftësimin profesional, aktivitetet punuese, përmbushjen e detyrimeve familjare, mosndërrimin e

vendbanimit pa njoftuar Shërbimin Sprovues, heqjen dorë nga alkooli ose droga, ndalimin e frekuentimit të vendeve të caktuara, ndalimin e kontaktimit me persona të caktuar, heqjen dorë nga mbajtja e armëve, kompensimin e viktimës, kthimin e dobisë pasurore, kufizimin e përdorimit të kompjuterit ose internetit dhe ofrimin e raporteve financiare.

Standardet ndërkombëtare e shpjegojnë rëndësinë e këtyre detyrimeve. Rregullat e Tokios përcaktojnë se kushtet që vendosen në kuadër të masave alternative ndaj dënimeve me burgim duhet të jenë praktike, të sakta dhe sa më të pakta, si dhe të synojnë uljen e mundësisë së përsëritjes së veprës dhe rritjen e mundësive për integrim social, duke marrë parasysh edhe nevojat e viktimës.⁴ Kjo nënkupton se problemi nuk zgjidhet duke vendosur detyrime formale. Detyrimi duhet të jetë i qartë, i nevojshëm dhe i lidhur me rrezikun konkret. Pra, dënimi me kusht jo vetëm formalisht duhet të jetë i kushtëzuar.

Rregullat e Këshillit të Evropës për Shërbimin Sprovues e vendosin Shërbimin Sprovues në funksion të uljes së recidivizmit. Sipas këtyre rregullave, shërbimet sprovuese duhet të ndërtojnë marrëdhënie pozitive me kryesit, me qëllim mbikëqyrjen, udhëzimin dhe ndihmën e tyre, duke kontribuar në sigurinë publike dhe administrimin e drejtë të drejtësisë.⁵ Kjo qasje e bën të qartë se mbikëqyrja nuk është aspekt formal, por mjet praktik penal në parandalimin e kriminalitetit dhe fuqizimin e efektivitetit të dënimeve të shqiptuara.

Rregullat Evropiane për Sanksionet dhe Masat në Komunitet të Këshillit të Evropës i përkufizojnë këto masa si sanksione që e mbajnë kryesin në komunitet, por që vendosin kufizime përmes kushteve ose detyrimeve.⁶ Kjo është arsyeja pse dënimi me kusht duhet kuptuar si formë e kontrollit më pak e ashpër se burgimi, por që mund të jetë më efektive nëse lidhet me detyrime konkrete.

Edhe Bashkimi Evropian, përmes Vendimit Kornizë 2008/947/JHA, e trajton mbikëqyrjen e masave sprovuese si instrument për rehabilitim social, kontroll të përmbushjes së detyrimeve, parandalim të recidivizmit dhe mbrojtje të viktimave dhe publikut.⁷ Ky dokument liston si masa tipike obligimin për njoftim të ndryshimit të vendbanimit ose punës, ndalimin e hyrjes në vende të caktuara, kufizimin e lëvizjes, raportimin tek autoriteti, bashkëpunimin me zyrtarin sprovues dhe trajtimin terapeutik ose trajtimin për varësi. Këto janë shumë të ngjashme me detyrimet e parapara me Kodin nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës. .

Në këtë drejtim, rëndësia e detyrimeve është trefishe. Së pari, ato e individualizojnë dënimin. Gjykata nuk mjaftohet me konstatimin se dënimi me kusht lejohet, por përcakton çfarë duhet të bëjë ose të mos bëjë i dënuari gjatë periudhës verifikuese. Së dyti, ato e bëjnë dënimin të kontrollueshëm. Nëse i dënuari ka detyrim për trajtim, për kompensim, për moskontaktim ose për

⁴ Tokyo Rules, Rule 12.2.

⁵ Council of Europe Probation Rules, CM/Rec(2010)1, Rule 1.

⁶ European Rules on Community Sanctions and Measures, CM/Rec(2017)3, Definitions and Basic Principles.

⁷ Council Framework Decision 2008/947/JHA, Recitals 8 and 10; Article 4(1).

raportim, atëherë përmbushja ose mospërmbushja mund të kontrollohet. Së treti, ato e lidhin dënimin me viktimën dhe komunitetin, sidomos kur detyrimi synon kompensimin e dëmit, kthimin e dobisë pasurore ose shmangien e kontaktit me viktimën.

Për shembull, në një rast të posedimit të narkotikëve, shqiptimi i dënimit me kusht pa asnjë detyrim mund të mos adresojë faktorët që kanë ndikuar në kryerjen e veprës. Nëse nga rrethanat del se kryesi ka problem me përdorimin e substancave narkotike, atëherë detyrimi për trajtim, këshillim ose heqje dorë nga përdorimi i drogës është më i lidhur me qëllimin e dënimit sesa vetëm periudha verifikuese. Në një rast të mashtrimit ose vjedhjes, dënimi me kusht pa urdhër për kompensim të viktimës ose kthim të dobisë pasurore rrezikon njërin nga qëllimet themelore të dënimit: kompensimin e viktimës ose komunitetit për humbjen e shkaktuar.

Megjithatë, rëndësia e detyrimeve nuk nënkupton se ato duhet të shqiptohen në çdo rast. Rekomandimi i vjetër i Këshillit të Evropës për sanksionet dhe masat në komunitet, i cili më vonë u zëvendësua me standardet e vitit 2017, kishte theksuar se kushtet dhe detyrimet duhet të jenë të përcaktuara qartë me ligj, ndërsa kohëzgjatja e tyre nuk duhet të jetë e pacaktuar.⁸ Edhe Komisioni për Reformë Ligjore të Irlandës thekson se kushtet e një dënimi të pezulluar duhet të jenë proporcionale dhe t'i japin të dënuarit mundësi reale për t'i përmbushur.⁹ Prandaj, detyrimet nuk duhet të jenë as mekanike, as të pamundura. Ato duhet të jenë të arsyetuara dhe të zbatueshme.


Duke pasur parasysh rëndësinë që këto detyrime specifike paraqesin në fuqizimin e dënimit me kusht, aplikimi i tyre në praktikë është i domosdoshëm për ta bërë këtë lloj të dënimit efektiv. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në sistemin gjyqësor të Kosovës, ku dënimi me kusht shqiptohet në masë të madhe nga gjykatat vendore. Nëse ky dënim shqiptohet pa detyrime konkrete dhe pa vlerësim individual, ai rrezikon të mbetet vetëm pezullim formal i dënimit, pa ndikim të mjaftueshëm, sipas asaj që u tha më lartë. Për këtë arsye, IKD ka analizuar praktikën gjyqësore me qëllim të vlerësimit të shkallës reale të aplikimit të detyrimeve specifike me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht. Gjetjet e kësaj analize paraqiten në vijim.

⁸ Council of Europe Recommendation R(92)16, Rules 3, 4 and 5.

⁹ Laë Reform Commission of Ireland, *Suspended Sentences*, 2020, Rec. 4.10.

5. Niveli i aplikimit të detyrimeve me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht

Nga 300 aktgjykimet e analizuara, në të cilat janë identifikuar 320 dënime me kusht, gjykatat kanë shqiptuar vetëm 17 detyrime specifike, që përbën rreth 5.3% të rasteve në raport me numrin e dënimeve me kusht. Po ashtu, vetëm 12 nga 300 aktgjykime kanë përmbajtur detyrime, që përfaqëson rreth 4% të aktgjykimeve të analizuara. Këto të dhëna tregojnë se detyrimet aplikohen në nivel shumë të ulët dhe se dënimi me kusht, në shumicën dërrmuese të rasteve, mbetet vetëm pezullim formal i ekzekutimit të dënimit, pa u lidhur me detyrime specifike siç e parasheh ligji.



Grafika 1. Numri i detyrimeve të aplikuara në 300 aktgjykimet e analizuara gjatë viteve 2023-2025.

Sa i përket shpërndarjes sipas gjykatave, numri më i madh i detyrimeve është shqiptuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë me nëntë detyrime (rreth 52.9% e të gjitha detyrimeve), pasuar nga Gjykata Themelore në Gjilan me tri detyrime (17.6%), Prizreni dhe Peja me nga dy detyrime secila (nga 11.8%), si dhe Ferizaj me një detyrim (5.9%). Në aktgjykimet e analizuara nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe ajo në Gjakovë nuk është evidentuar asnjë detyrim. Po ashtu, 16 nga 17 detyrimet (94.1%) janë shqiptuar në Departamentin e Përgjithshëm, ndërsa vetëm një detyrim (5.9%) në Departamentin për Krime të Rënda.

Gjykatat	Aktgjykimet e analizuara	Aktgjykime me detyrime	Numri i detyrimeve	DS	DKR	DP
Prishtinë	60	0	0	0	0	0
Mitrovicë	40	4	9	/	0	9
Gjakovë	40	0	0	/	0	0
Prizren	40	2	2	/	0	2
Ferizaj	40	1	1	/	0	1
Gjilan	40	3	3	/	1	2
Pejë	40	2	2	/	0	2
Gjithsej	300	12	17	0	1	16

Tabela 1. Detyrimet e shqiptuara gjatë viteve 2023-2025 nga Gjykatat Themelore në Kosovë të ndara në Departamente.

Sa i përket shpërndarjes ndër vite, është evidentuar një rritje graduale e aplikimit të detyrimeve: një detyrim në vitin 2023 (5.9%), tri detyrime në vitin 2024 (17.6%) dhe 13 detyrime në vitin 2025 (76.5%). Megjithatë, edhe kjo rritje nuk ndryshon përfundimin kryesor: në raport me numrin e aktgjykimeve dhe dënimeve me kusht të analizuar, aplikimi i detyrimeve specifike mbetet i rrallë dhe nuk përbën ende një praktikë të zbatuar gjyqësore.



Grafika 2. Detyrimet e shqiptuara nga Gjykatat Themelore në Kosovë gjatë viteve 2023-2025. ¹⁰


Të dhënat si më lartë janë pjesë e analizës së aktgjykimeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore, sipas metodologjisë së elaboruar tanimë në pikën II të këtij raporti. Megjithatë, gjatë konsultimit të gjetjeve të raportit me akterët relevantë, Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar për 12 raste në të cilat dënimet me kusht janë shoqëruar me detyrime specifike sipas nenit 56 të Kodit Penal. Ndërkaq, Gjykata Themelore në Gjakovë ka njoftuar për 26 aktgjykime në të cilat janë shqiptuar detyrime të kësaj natyre. Këto raste nuk kanë qenë pjesë e mostrës prej 300 aktgjykimesh dhe nuk janë përfshirë në përlogaritjet statistikore të raportit.

6. Aplikimi sipas llojit të detyrimit

Nga 15 llojet e detyrimeve që mund të shqiptohen sipas Kodit Penal 06/L-074 [neni 56], në aktgjykimet e analizuar janë aplikuar vetëm gjashtë lloje. Detyrimi më i aplikuar është kompensimi ose dëmshpërblimi i viktimës së veprës penale, i shqiptuar në pesë raste. Pas tij vjen heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës, në katër raste, nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose rehabilitimit, në tri raste, si dhe kthimi i dobisë pasurore dhe vizitat te psikologu ose këshilluesit e tjerë, në nga dy raste. Vetëm në një rast është shqiptuar detyrimi për heqje dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar.

¹⁰ Për gjatë çdo viti të paraqitur në tabelë janë analizuar nga rreth 100 aktgjykime ku është shqiptuar dënimi me kusht e të cilat janë zgjedhur në mënyrë rastësore në web faqen e KGJK-së.

Këto të dhëna tregojnë se edhe kur gjykatat kanë vendosur detyrime specifike, ato janë përqendruar në pak lloje të tyre. Në parim, kjo është pozitive për atë sa detyrimet më të aplikuara lidhen me kompensimin e viktimës dhe trajtimin e faktorëve që mund të ndikojnë në përsëritjen e veprës, si përdorimi i alkoolit apo drogës. Megjithatë, mungesa e aplikimit të nëntë llojeve të tjera të detyrimeve tregon se gjykatat nuk e shfrytëzojnë plotësisht gamën e mjeteve që Kodi Penal ua jep në dispozicion për ta individualizuar dhe fuqizuar dënimin me kusht.



Grafika 3. Numri i llojeve të detyrimeve të aplikuara nga gjykatat themelore në Kosovë.

7. Aplikimi sipas llojit të veprës penale

IKD ka analizuar aplikimin e detyrimeve specifike edhe sipas llojit të veprës penale. Brenda kësaj margjine të kufizuar të aplikimit të këtyre detyrimeve, siç janë elaboruar më lartë, të dhënat në vijim paraqesin shpërndarjen e detyrimeve të shqiptuara sipas kategorive të veprave penale.

Nga të dhënat e analizuara del se aplikimi më i lartë i detyrimeve është evidentuar tek veprat penale kundër pasurisë, ku nga 50 aktgjykime të analizuara për këtë kategori, në shtatë prej tyre janë shqiptuar detyrime. Pas kësaj kategorie vijnë veprat penale të narkotikëve, ku nga 50 aktgjykime të analizuara, detyrime janë shqiptuar në tri aktgjykime. Ndërsa, tek veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik dhe veprat penale kundër jetës dhe trupit, detyrime janë shqiptuar vetëm në nga një rast. Në anën tjetër, në aktgjykimet e analizuara për veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme, korrupsionit zyrtar dhe veprave penale të armëve, nuk është evidentuar asnjë rast i shqiptimit të detyrimeve specifike.

Këto të dhëna tregojnë se detyrimet specifike nuk aplikohen mjaftueshëm as në kategoritë ku ato mund të kenë rëndësi të veçantë. Tek veprat penale kundër pasurisë, detyrimet si kompensimi i viktimës apo kthimi i dobisë pasurore lidhen drejtpërdrejt me natyrën e veprës. Tek veprat penale të narkotikëve, detyrimet për trajtim, këshillim apo heqje dorë nga përdorimi i drogës mund të ndikojnë në adresimin e faktorëve që kanë sjellë deri tek vepra penale. Ngjashëm, tek veprat që lidhen me dhunën, kanosjen, armët apo rrezikun e përgjithshëm, detyrimet mund të shërbejnë si mekanizma konkretë për kontrollin e sjelljes dhe parandalimin e veprave të reja penale.

Për këtë arsye, problemi nuk qëndron vetëm në numrin e ulët të detyrimeve të shqiptuara në përgjithësi. Problemi qëndron edhe në faktin se këto detyrime nuk janë shndërruar në praktikë të qëndrueshme gjyqësore as në rastet ku, sipas natyrës së veprës penale, ato do të mund të ishin veçanërisht relevante. Kjo tregon se potenciali i dënimit me kusht për t'u individualizuar dhe fuqizuar përmes detyrimeve specifike ende mbetet i pashfrytëzuar mjaftueshëm.

Pasuria	50 aktgjykime të analizuara	7 aktgjykime me detyrime
Narkotikët	50 aktgjykime të analizuara	3 aktgjykime me detyrime
Siguria e Përgjithshme	40 aktgjykime të analizuara	0 aktgjykime me detyrime
Korrupsioni	40 aktgjykime të analizuara	0 aktgjykime me detyrime
Siguria në Trafik	40 aktgjykime të analizuara	1 aktgjykim me detyrim
Jeta dhe trupi	50 aktgjykime të analizuara	1 aktgjykim me detyrim
Armët	30 aktgjykime të analizuara	0 aktgjykime me detyrim

Grafika 4. Numri i aktgjykimeve ku është aplikuar detyrimi krahas numrit të aktgjykimeve të analizuara sipas veprave penale.


8. Mosarsyetimi lidhur me moscaktimin e detyrimit

Përtej nivelit të ulët të aplikimit të detyrimeve specifike, problem në vete paraqet edhe mungesa e arsyetimit për moscaktimin e tyre. Nga 288 aktgjykimet në të cilat nuk është shqiptuar asnjë detyrim specifik, IKD nuk ka evidentuar asnjë rast ku gjykata ka dhënë arsyetim se pse, në rrethanat konkrete të rastit, nuk ka qenë e nevojshme caktimi i ndonjë detyrimi.

Kjo nënkupton se çështja e detyrimeve specifike është injoruar pothuajse tërësisht në arsyetimin e aktgjykimeve. Gjykatat, në shumicën dërrmuese të rasteve, kanë vendosur për dënim me kusht pa trajtuar fare nëse ky dënim duhet të shoqërohet me ndonjë detyrim konkret. Në mungesë të një arsyetimi të tillë, nuk mund të kuptohet nëse gjykata e ka vlerësuar nevojën për detyrime dhe ka arritur në përfundimin se ato nuk janë të nevojshme, apo nëse këtë çështje nuk e ka shqyrtuar fare.

Kjo praktikë e formalizon dënimin me kusht. Kur gjykata nuk sqaron pse dënimi me kusht shqiptohet pa detyrime, sidomos në raste ku natyra e veprës penale ose rrethanat personale të kryesit mund ta arsyetojnë një detyrim të tillë, atëherë krijohet perceptimi se nuk kemi zbatueshmëri të ulët për shkak të specifikave të rastit, por injorim të këtyre detyrimeve nga Gjykatat.

Për këtë arsye, problemi nuk qëndron vetëm në faktin se detyrimet shqiptohen rrallë. Problem po aq i rëndësishëm është se, edhe kur nuk shqiptohen, gjykatat nuk japin asnjë arsyetim për këtë mosveprim. Kjo krijon perceptimin se mundësia e caktimit të detyrimeve specifike nuk është shqyrtuar fare, përderisa një vlerësim i tillë nuk reflektohet në aktgjykim.



Grafika 5. Numri i arsyetimeve për mosshqiptimin e detyrimeve në 288 aktgjykimet e analizuara.

9. Mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues

Përveç detyrimeve specifike, IKD ka analizuar edhe rastet kur gjykatat kanë urdhëruar mbikëqyrjen e të dënuarit nga Shërbimi Sprovues. Kjo gjetje duhet dalluar nga detyrimet specifike. Mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues nënkupton se gjykata e ka vendosur të dënuarin në kontakt me këtë shërbim, me qëllim të përcjelljes së sjelljes së tij gjatë periudhës verifikuese. Por, kjo mbikëqyrje nuk nënkupton domosdoshmërisht se gjykata ka caktuar edhe detyrime konkrete sipas Kodit Penal.

Nga 300 aktgjykimet e analizuara, IKD ka evidentuar 23 aktgjykime në të cilat është urdhëruar mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues. Nga këto, në 18 aktgjykime mbikëqyrja është urdhëruar pa u caktuar ndonjë detyrim specifik, ndërsa në pesë aktgjykime mbikëqyrja është shoqëruar edhe me detyrime konkrete. Kjo tregon se gjykatat, në disa raste, e kanë aktivizuar Shërbimin Sprovues, por pa i dhënë gjithmonë përmbajtje konkrete mbikëqyrjes përmes detyrimeve të qarta.

Në parim, përfshirja e Shërbimit Sprovues është pozitive, pasi mundëson përcjelljen e sjelljes së të dënuarit dhe rrit mundësinë që dënimi me kusht të mos mbetet vetëm masë formale. Megjithatë, kur mbikëqyrja urdhërohet pa detyrime specifike, roli i saj mbetet i pa objekt. Për këtë arsye, edhe pse këto 23 raste tregojnë një përdorim të Shërbimit Sprovues, gjetja kryesore mbetet se dënimi me kusht rrallë strukturohet plotësisht, me përmbajtje konkrete gjatë periudhës verifikuese dhe mbikëqyrje nga Shërbimi Sprovues.



Grafika 6. Numri i aktgjykimeve ku është urdhëruar mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

10. Pasojat e mosshqiptimit të obligimeve

Dënimi me kusht nuk duhet të kuptohet vetëm si mosekzekutim i dënimit me burgim. Ai është dënim alternativ, i cili duhet të shërbejë për arritjen e qëllimeve të dënimit pa pasur nevojë për privim efektiv nga liria. Për këtë arsye, në rastet kur rrethanat e rastit e kërkojnë, dënimi me kusht duhet të shoqërohet me detyrime konkrete, të cilat i japin përmbajtje periudhës verifikuese dhe e bëjnë këtë dënim më efektiv. Kjo është pikërisht edhe qasja që ka ndjekur Kodi Penal 06/L-074.

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se në praktikën gjyqësore, detyrimet specifike aplikohen vetëm përjashtimisht. Nga 300 aktgjykime të analizuara, në të cilat janë identifikuar 320 dënime me kusht, janë shqiptuar vetëm 17 detyrime specifike. Po ashtu, në 288 aktgjykime ku nuk janë shqiptuar detyrime, gjykatat nuk kanë dhënë asnjë arsyetim për mosaktimin e tyre. Kjo tregon se problemi nuk qëndron vetëm në numrin e ulët të detyrimeve, por edhe në mungesën e vlerësimit të dukshëm gjyqësor për nevojën e tyre.

Mosshqiptimi i detyrimeve specifike, sidomos pa arsyetim, prodhon pasoja në tri drejtime kryesore. Së pari, e dobëson arritjen e qëllimit të dënimit. Së dyti, e formalizon dënimin me kusht. Së treti, e shndërron kushtin në një “kusht pa kushte”, ku i dënuari përfiton nga pezullimi i ekzekutimit të dënimit, por pa u obliguar të ndërmarrë veprime konkrete, të cilat mund të shqiptohen sipas Kodit Penal 06/L-074.

a. Qëllimi i dënimit

Kodi Penal 06/L-074 përcakton se qëllimi i dënimit është parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe rehabilitimi i tij, parandalimi i personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, kompensimi i viktimave ose komunitetit dhe shprehja e gjykimit shoqëror ndaj veprës penale [neni 38]. Këto qëllime vlejné edhe kur gjykata shqipton dënim me kusht. Fakti që dënimi nuk ekzekutohet menjëherë nuk e liron gjykatën nga detyrimi për të siguruar që sanksioni i shqiptuar të jetë në gjendje të arrijë qëllimet e tij.

Në këtë kontekst, detyrimet specifike janë mjet për ta lidhur dënimin me kusht me qëllimet e dënimit. Përmes tyre, gjykata mund të ndikojë në rehabilitimin e kryesit, të urdhërojë kompensimin e viktimës, të kufizojë sjellje të caktuara të rrezikshme ose të vendosë forma të kontrollit gjatë

periudhës verifikuese. Pa këto detyrime, dënimi me kusht mbetet kryesisht kërcënim abstrakt se dënimi do të ekzekutohet nëse kryhet vepër e re penale.

Kjo është veçanërisht problematike në rastet kur natyra e veprës penale tregon nevojë të qartë për ndërhyrje konkrete. Tek veprat penale kundër pasurisë, kompensimi i viktimës ose kthimi i dobisë pasurore lidhen drejtpërdrejt me pasojën e veprës. Tek veprat penale të narkotikëve, trajtimi, këshillimi apo heqja dorë nga përdorimi i drogës mund të jenë vendimtare për parandalimin e përsëritjes. Tek rastet që përfshijnë dhunë, kanosje, armë apo rrezik të përgjithshëm, ndalimi i kontaktit apo ndalimi i frekuentimit të vendeve të caktuara mund të shërbejnë si masa konkrete mbrojtëse dhe parandaluese.

Prandaj, mosshqiptimi i detyrimeve specifike e zbeh qëllimin e dënimit me kusht. Kur gjykata nuk e lidh këtë dënim me ndonjë masë konkrete rehabilitimi, kompensimi apo kontrolli, ajo e redukton dënimin me kusht në një vendim që kryesisht e shtyn ose e shmang ekzekutimin e burgimit, por pa ndërtuar mekanizëm real për arritjen e qëllimit të dënimit.

b. Formalizimi i dënimit

Dënimi me kusht rrezikon të formalizohet kur shqiptohet vetëm në formë të pezullimit të ekzekutimit të dënimit, pa analizë të mjaftueshme mbi nevojën për detyrime specifike. Në këto raste, gjykata e cakton dënimin, e cakton periudhën verifikuese, por nuk e strukturon këtë periudhë me përmbajtje konkrete. Kjo e largon dënimin me kusht nga funksioni i tij real si masë alternative dhe e afron atë me një vendim formal.

Gjetjet e raportit tregojnë se formalizimi i këtij sanksioni penal paraqet rrezik real. Detyrimet specifike janë shqiptuar vetëm në 12 nga 300 aktgjykimet e analizuara. Edhe më problematike është se në 288 aktgjykimet ku nuk janë shqiptuar detyrime, nuk është dhënë asnjë arsytim pse detyrimet nuk janë konsideruar të nevojshme. Kjo do të thotë se në aktgjykim nuk reflektohet fare nëse gjykata e ka shqyrtuar mundësinë e caktimit të tyre.

Në parim, mosshqiptimi i detyrimeve mund të jetë plotësisht i pranueshëm nëse gjykata sqaron se, në rrethanat e rastit konkret, ato nuk janë të nevojshme. Por, kur mungon çdo arsytim, krijohet perceptimi se detyrimet specifike nuk janë trajtuar fare si pjesë e individualizimit të dënimit. Kjo është ajo që e formalizon dënimin me kusht: jo vetëm mosshqiptimi i detyrimeve, por mosvlerësimi i nevojës për shqiptimin e tyre.

Kjo praktikë ka ndikim edhe në cilësinë e aktgjykimit. Aktgjykimi nuk duhet vetëm të tregojë se çfarë dënimi është shqiptuar, por edhe pse ky dënim është i përshtatshëm për rastin konkret dhe se si synohet që i njëjti të arrijë qëllimet e dënimit, që janë kruciale në raport me secilin sanksion penal.

c. Kushti “pa kushte”

Në kuptimin ligjor, dënimi me kusht gjithmonë përmban të paktën një kusht themelor: i dënuari nuk duhet të kryejë vepër tjetër penale gjatë periudhës verifikuese. Megjithatë, në kuptimin praktik, ky kusht shpesh nuk mjafton për ta bërë dënimin me kusht efektivisht të kushtëzuar. Nëse gjykata nuk cakton asnjë detyrim konkret dhe nuk aktivizon mekanizma të përcjelljes, dënimi me kusht mbetet kryesisht një pritje pasive që i dënuari të mos kryejë vepër të re penale.

Për këtë arsye, në praktikë krijohet fenomeni i “kushtit pa kushte”. Kjo nuk nënkupton se dënimi me kusht nuk ka fare kusht në kuptimin formal, por nënkupton se, përtej kushtit minimal të moskryerjes së veprës së re penale, gjykata nuk vendos asnjë obligim të matshëm dhe të kontrollueshëm për të dënuarin. I dënuari nuk obligohet të kompensojë viktimën, të kthejë dobinë pasurore, të ndjekë trajtim, të shmangë kontaktin me persona të caktuar, të heqë dorë nga alkooli, droga apo armët, apo të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër relevant për rastin, siç përcaktohet me Kodin Penal 06/L-074.

Kjo e dobëson seriozisht kuptimin e kushtëzimit. Dënimi me kusht duhet të krijojë një periudhë verifikuese me përmbajtje, ku sjellja e të dënuarit vlerësohet jo vetëm në kuptimin negativ, pra a ka kryer apo jo vepër të re penale, por edhe në kuptimin pozitiv, pra a ka përmbushur obligimet që lidhen me rehabilitimin, kompensimin dhe parandalimin. Pa këto elemente, periudha verifikuese nuk shfrytëzohet si mundësi për ndërhyrje penale proporcionale dhe efektive.

Kjo është arsyeja pse detyrimet specifike janë të rëndësishme. Ato nuk duhet të shqiptohen mekanikisht dhe as në çdo rast. Mirëpo, në rastet kur natyra e veprës, rreziku, nevojat e kryesit ose interesi i viktimës e arsyetojnë një gjë të tillë, mungesa e tyre e bën dënimin me kusht të zbrazët në përmbajtje. Në këto raste, kushti mbetet vetëm në letër, ndërsa dënimi me kusht nuk arrin ta realizojë potencialin e tij si masë alternative, rehabilituese dhe parandaluese. Përfundimisht, kjo situatë e krijon fenomenin e "Kushtit pa kushte".

11. Dënimi më i lartë se kushtëzimi

Në aspektin formal, Kodi Penal 06/L-074 nuk përcakton shprehimisht se periudha verifikuese duhet të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e dënimit të shqiptuar. Ky Kod përcakton se koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit dhe as më e gjatë se pesë vite [neni 48], ndërsa dënimi me kusht mund të shqiptohet nëse gjykata shqipton dënim me burgim deri në dy vite [neni 49]. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se çdo kombinim brenda këtyre kufijve është i arsyeshëm.

Në dy aktgjykime të analizuara, IKD ka evidentuar raste kur kohëzgjatja e dënimit me kusht ka qenë më e lartë se kohëzgjatja e periudhës verifikuese. Konkretisht, IKD ka gjetur një rast kur gjykata ka shqiptuar dënim me kusht prej dy vite burgim dhe 2,000 euro gjobë, ndërsa periudhën verifikuese e ka caktuar në kohëzgjatje prej një viti. Situatë e njëjtë është evidentuar edhe në një

rast tjetër, ku po ashtu është shqiptuar dënim me kusht prej dy vite burgim dhe 2,000 euro gjobë, ndërsa periudha verifikuese është caktuar në një vit.

Kjo vendimmarrje është e pakuptimtë në raport me vetë natyrën e dënimit me kusht. Në thelb, gjykata i ka shqiptuar të dënuarit dy vite burgim me kusht, por e ka mbajtur nën verifikim vetëm për një vit. Pra, një dënim prej dy vitesh burgim, i cili nuk ekzekutohet për shkak të kushtëzimit, praktikisht “konsumohet” pas vetëm një viti periudhë verifikuese. Kjo e cenon në thelb kuptimin e kushtëzimit dhe e bën të paqartë logjikën ndëshkuese, parandaluese dhe kushtëzuese të vendimit.

Qëllimi i periudhës verifikuese është që i dënuari, për një periudhë të caktuar kohore, të qëndrojë nën kërcënimin real të ekzekutimit të dënimit nëse kryen vepër të re penale ose nuk i respekton kushtet e vendosura nga gjykata. Kur dënimi i shqiptuar është dy vite burgim, ndërsa periudha verifikuese vetëm një vit, atëherë dënimi kryesor eklipsohet nga periudha e kushtëzuar. Kjo krijon një situatë të pazakonshme: sa më i lartë dënimi i pezulluar, aq më e madhe do të duhej të ishte nevoja për një periudhë kuptimplotë verifikimi dhe jo e kundërta.

Në mungesë të një arsyetimi, krijohet përshtypja se periudha verifikuese është caktuar në mënyrë formale, pa u lidhur me lartësinë e dënimit, rrezikun e përsëritjes së veprës dhe nevojën për kontroll efektiv pas shqiptimit të aktgjykimit.

12. Recidivizmi

Në kuadër të analizës së aktgjykimeve, IKD ka shqyrtuar edhe nëse në aktgjykimet e përfshira në mostër evidentohet se personi ndaj të cilit është shqiptuar dënimi me kusht ka qenë më parë i dënuar apo ka kryer vepra penale edhe më herët. Ky evidentim është bërë vetëm mbi bazën e përmbajtjes së aktgjykimit përkatës, pa u mbështetur në kërkime të jashtme, evidenca të tjera penale apo burime jashtë aktgjykimit.

Nga 300 aktgjykimet e analizuara, në 28 prej tyre evidentohet se i dënuari ka qenë më parë i dënuar apo se ka kryer vepra penale edhe më herët. Kjo përbën 9.3% të aktgjykimeve të analizuara. Në 122 aktgjykime, apo 40.7% të rasteve, aktgjykimi përmban formulime nga të cilat rezulton se i dënuari nuk ka qenë i dënuar më parë. Ndërkaq, në 150 aktgjykime, apo 50% të rasteve, kjo çështje nuk evidentohet në aktgjykim.

Brenda 28 rasteve ku në aktgjykim evidentohet e kaluara penale e të dënuarit, IKD ka analizuar edhe natyrën e përsëritjes së veprave penale. Nga kjo analizë rezulton se në pesë (5) raste bëhet fjalë për përsëritje të veprës së njëjtë penale. Në tri (3) raste, vepra e mëparshme është e së njëjtës natyrë me veprën për të cilën është shqiptuar dënimi me kusht. Në 11 raste, aktgjykimi evidenton se i dënuari më parë ka kryer vepër tjetër penale. Në një (1) rast evidentohet se i dënuari ka pasur si vepra të njëjta, ashtu edhe vepra të tjera penale të mëparshme. Ndërkaq, në shtatë (7) raste, aktgjykimi e evidenton faktin se personi ka qenë i dënuar më parë, por nuk specifikon qartë natyrën e veprës së mëparshme. Në një (1) rast janë identifikuar formulime

kundërthënëse në aktgjykim lidhur me të kaluarën penale të të dënuarit. Madje, në njërin prej këtyre rasteve, përkundër që vepra e kryer më para ishte vrasje, gjykata shqiptoi dënim me kusht për veprën penale “lëndim i rëndë trupor” pa asnjë detyrim specifik.

Kjo ndarje tregon se recidivizmi i evidentuar në aktgjykime nuk paraqitet në një formë të vetme. Në disa raste bëhet fjalë për përsëritje të së njëjtës veprë penale, në disa raste për vepra të së njëjtës natyrë, ndërsa në numrin më të madh të rasteve ku kjo çështje evidentohet, bëhet fjalë për vepra të tjera penale. Kjo është e rëndësishme për mënyrën se si gjykata duhet ta arsyetojë vendimin për shqiptimin e dënimit me kusht, pasi natyra e veprës së mëparshme mund të ketë rëndësi në vlerësimin e rrezikut të përsëritjes, personalitetit të kryesit dhe nevojës për detyrime specifike.

Në rastet kur bëhet fjalë për përsëritje të veprës së njëjtë apo të ngjashme, nevoja për arsyetim të plotë është edhe më e theksuar. Në këto raste, gjykata duhet të sqarojë pse, pavarësisht faktit se i dënuari edhe më parë ka kryer veprë të njëjtë apo të ngjashme, dënimi me kusht konsiderohet i mjaftueshëm për arritjen e qëllimit të dënimit. Po ashtu, në këto raste është veçanërisht e rëndësishme të vlerësohet nëse dënimi me kusht duhet të shoqërohet me ndonjë detyrim specifik, përmes të cilit do të adresohet më konkretisht sjellja e të dënuarit dhe do të zvogëlohet rreziku i përsëritjes së veprës penale.

Edhe në rastet kur vepra e mëparshme nuk është e njëjtë me veprën për të cilën është shqiptuar dënimi me kusht, e kaluara penale mbetet rrethanë relevante për individualizimin e dënimit. Në këto raste, gjykata duhet të tregojë se e ka vlerësuar këtë rrethanë dhe se, pavarësisht saj, ka arritur në përfundim se qëllimi i dënimit mund të arrihet pa ekzekutimin e dënimit me burgim. Ky arsyetim është i rëndësishëm për të kuptuar nëse vendimi për dënim me kusht është rezultat i një analize konkrete apo vetëm vazhdimësi e një praktike të përgjithshme të shqiptimit të dënimeve alternative.

Të dhënat tregojnë po ashtu se në një numër rastesh aktgjykimi e përmend të kaluarën penale të të dënuarit, por nuk specifikon natyrën e veprës së mëparshme. Kjo e kufizon mundësinë për të vlerësuar se çfarë rëndësie i ka dhënë gjykata kësaj rrethanë gjatë individualizimit të dënimit. Kur aktgjykimi nuk e bën të qartë nëse vepra e mëparshme është e njëjtë, e ngjashme apo krejtësisht tjetër, bëhet më e vështirë të kuptohet pesha që kjo rrethanë ka pasur në vendimin për dënim me kusht, në përcaktimin e periudhës së verifikimit dhe në mosshqiptimin eventual të detyrimeve specifike.

Kjo çështje lidhet drejtpërdrejt me një ndër gjetjet kryesore të raportit për mungesën e arsytimit të mjaftueshëm në aktgjykime. Kur gjykata shqipton dënim me kusht ndaj një personi për të cilin vetë aktgjykimi evidenton se ka kryer vepra penale edhe më herët, arsyetimi duhet të jetë më i detajuar. Gjukata duhet të sqarojë pse dënimi me kusht është i përshtatshëm, pse periudha e verifikimit është caktuar në atë kohëzgjatje dhe pse është ose nuk është shqiptuar ndonjë detyrim specifik.

Kjo nuk nënkupton se çdo rast ku evidentohet e kaluara penale duhet domosdoshmërisht të përfundojë me dënim efektiv me burgim apo me shqiptim automatik të detyrimeve specifike. Dënimi me kusht mund të jetë i përshtatshëm edhe në raste të caktuara kur personi ka të kaluar penale. Megjithatë, në këto raste kërkohet arsyetim konkret dhe individualizim më i kujdesshëm i dënimit, për të treguar se gjykata ka vlerësuar realisht rrethanat personale të të dënuarit, sjelljen e tij të mëparshme dhe mundësinë e arritjes së qëllimit të dënimit pa ekzekutimin e dënimit me burgim.

Nga ana tjetër, numri i madh i aktgjykimeve ku nuk evidentohet fare kjo çështje tregon një problem më të gjerë të përmbajtjes dhe arsytimit të aktgjykimeve. Kur aktgjykimi nuk tregon nëse i dënuari ka apo nuk ka të kaluar penale, është e vështirë të kuptohet nëse gjykata e ka vlerësuar këtë element gjatë individualizimit të dënimit. Kjo ndikon edhe në mundësinë për të vlerësuar nëse dënimi me kusht është shqiptuar pas një analize të plotë të rrethanave personale të të dënuarit.

Në linjë me gjetjet e tjera të këtij raporti, edhe analiza e recidivizmit të evidentuar në aktgjykime e forcon nevojën për arsyetim më të plotë të vendimeve gjyqësore. Gjykatat duhet të pasqyrojnë qartë rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit me kusht, përfshirë edhe të kaluarën penale të të dënuarit, kur ajo ekziston ose kur është konstatuar se mungon. Kjo do të mundësonte vlerësim më të mirë të individualizimit të dënimit, kontroll më efektiv nga instancat më të larta dhe transparencë më të madhe lidhur me mënyrën se si gjykatat e përdorin dënimin me kusht në praktikë.

Në përfundim, nga aktgjykimet e analizuara rezulton se recidivizmi evidentohet në një numër relativisht të kufizuar rastesh, ndërsa në gjysmën e aktgjykimeve kjo çështje nuk trajtohet fare. Në rastet ku evidentohet, më së shpeshti bëhet fjalë për vepra të tjera penale, ndërsa në një numër më të vogël rastesh për përsëritje të veprës së njëjtë apo të ngjashme. Kjo tregon se, përveç nevojës për aplikim më të madh dhe më të arsyetuar të detyrimeve specifike, ekziston edhe nevoja që gjykatat ta pasqyrojnë më qartë vlerësimin e tyre për të kaluarën penale të të dënuarit dhe ndikimin që kjo rrethanë ka pasur në shqiptimin e dënimit me kusht.

13. Përfundimet nga fokus grupi

Në kuadër të procesit të finalizimit të këtij raporti, IKD ka organizuar fokus grup me përfaqësues të sistemit gjyqësor, sistemit prokurorial, Shërbimit Sprovues të Kosovës, Akademisë së Drejtësisë dhe avokatisë. Qëllimi i këtij fokus grupi ishte diskutimi i gjetjeve kryesore të raportit, identifikimi i faktorëve që ndikojnë në aplikimin e ulët të detyrimeve specifike me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht, si dhe marrja e inputeve praktike nga akterët që përballen drejtpërdrejt me zbatimin e këtyre dispozitave në praktikë.

Në këtë diskutim mes tjerash u tha se dënimi me kusht aplikohet gjerësisht në praktikën gjyqësore në Kosovë. Megjithatë, pjesëmarrësit vlerësuan se ky dënim, në shumicën e rasteve, vazhdon të shqiptohet kryesisht përmes përcaktimit të dënimit kryesor dhe periudhës së verifikimit, pa u shoqëruar me detyrime specifike që do ta bënë atë më të individualizuar, më të matshëm dhe më efektiv në arritjen e qëllimit të dënimit.

Në fokus grup u theksua se detyrimet specifike nuk duhet të shqiptohen në mënyrë automatike në çdo rast të dënimit me kusht. Në veçanti, nga përfaqësues të gjyqësorit u theksua se secili rast duhet të vlerësohet në bazë të rrethanave konkrete, llojit të veprës penale, personalitetit të kryesit, dëmit të shkaktuar, pozitës së viktimës dhe mundësisë reale për zbatimin e detyrimit. Në anën tjetër, nga përfaqësues të prokurorisë u theksua se, në rastet kur vlerësohet se dënimi me kusht mund ta arrijë qëllimin e dënimit, prokurorët duhet të jenë më aktivë në propozimin e detyrimeve specifike të përshtatshme me natyrën e rastit. Megjithatë, përfundimi i përbashkët i diskutimit ishte se ky vlerësim duhet të pasqyrohet në arsyetimin e aktgjykimit. Pra, edhe kur gjykata vlerëson se nuk ka vend për shqiptimin e ndonjë detyrimi specifik, ajo duhet të japë arsyet pse në rastin konkret një detyrim i tillë nuk është i nevojshëm ose i përshtatshëm.

Nga përfaqësuesit e sistemit prokurorial u theksua nevoja që prokurorët të jenë më aktivë në propozimin e detyrimeve specifike, sidomos në fazën e propozimit për llojin dhe lartësinë e dënimit, si dhe në marrëveshjet për pranimin e fajësisë. U pranua se, në praktikë, prokurorët shpesh mjaftohen me propozimin e dënimit me kusht dhe periudhës së verifikimit, pa kërkuar edhe ndonjë detyrim konkret. Ky qëndrim u plotësua edhe nga përfaqësues të gjyqësorit, të cilët theksuan se mungesa e propozimeve apo ankesave në këtë drejtim ndikon që mosshqiptimi i detyrimeve specifike të kalojë në heshtje. Prandaj, në fokus grup u theksua nevoja që, në rastet kur vlerësohet se dënimi me kusht mund ta arrijë qëllimin e dënimit, të propozohen edhe detyrime specifike të përshtatshme me natyrën e rastit.

Në fokus grup u trajtua veçanërisht edhe roli i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë. Nga përfaqësuesit e prokurorisë u theksua se në shumë raste, përmes këtyre marrëveshjeve, palët dakordohen për propozimin e dënimit me kusht, por jo edhe për detyrime specifike. Si shembull, u përmendën rastet kur ekziston mundësia për kompensimin e dëmit të viktimës ose kthimin e dobisë pasurore, por këto detyrime nuk përfshihen në marrëveshje. Për këtë arsye, fokus grupi nxori në pah nevojën që marrëveshjet për pranimin e fajësisë të trajtohen si një mundësi e

rëndësishme për përfshirjen e detyrimeve specifike, veçanërisht në rastet kur ato janë të matshme dhe të zbatueshme.

Një çështje tjetër e rëndësishme ishte përdorimi i rrallë i seancës për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Në diskutim u theksua se kjo seancë do të mund të shërbente si hapësirë e rëndësishme për paraqitjen e rrethanave relevante, për diskutimin e mundësisë së shqiptimit të detyrimeve specifike dhe për individualizimin më të plotë të dënimit. Përdorimi i kufizuar i kësaj mundësie procedurale e zvogëlon hapësirën praktike për shqyrtim më të thelluar të nevojës për detyrime specifike.

Nga avokati u theksua se mosshqiptimi i detyrimeve specifike nuk paraqet domosdoshmërisht shqetësim në çdo rast, pasi vetë dënimi me kusht përmban kushtin themelor që i dënuari të mos kryejë vepër të re penale gjatë periudhës së verifikimit. Megjithatë, u theksua se shqetësuese mbetet mosaplikimi i detyrimeve që lidhen me kompensimin e viktimave, dëmshpërblimin dhe kthimin e dobisë pasurore në rastet kur dëmi është i qartë, i matshëm dhe mund të trajtohet pa zvarritur procedurën penale. Kjo do të mund të ndikonte edhe në shmangien e procedurave të mëvonshme civile për kompensim të dëmit.

Nga diskutimi rezultoi se raportet parandëshkuese të Shërbimit Sprovues mund të luajnë rol të rëndësishëm në vlerësimin e nevojës për detyrime specifike. Mirëpo, u theksua se këto raporte kërkojnë rrallë nga gjykatat, edhe pse ato mund të ofrojnë të dhëna të dobishme për rrethanat personale, sociale dhe psikologjike të të pandehurit. Në këtë drejtim, fokus grupi nxori në pah nevojën për përdorim më të madh të raporteve parandëshkuese, duke pasur parasysh se ato mund t'i ndihmojnë gjykatat në individualizimin e dënimit dhe në përzgjedhjen e detyrimeve më të përshtatshme. Megjithatë, nga përfaqësues të gjyqësorit u theksua se raportet dhe rekomandimet e Shërbimit Sprovues janë të mirëseardhura, por nuk janë detyruese për gjykatën dhe duhet të vlerësohen në raport me natyrën e veprës penale dhe rrethanat konkrete të rastit.

Nga Shërbimi Sprovues u theksua se ky institucion ka kapacitete për mbikëqyrjen e detyrimeve specifike dhe se gjatë periudhës së fundit është rritur numri i zyrtarëve sprovues. Megjithatë, u ngritën edhe dilema praktike lidhur me rastet kur aktgjykimi nuk e përcakton qartë rolin e Shërbimit Sprovues, ndërsa kjo përmendet vetëm në shkresën përcjellëse. Në këto raste, sipas diskutimit, krijohen paqartësi nëse Shërbimi Sprovues është i obliguar të ndërmarrë veprime mbikëqyrëse. Kjo e bën të nevojshme që aktgjykimet të jenë të qarta jo vetëm për detyrimin e shqiptuar, por edhe për institucionin përgjegjës për mbikëqyrjen e tij.

Në fokus grup u diskutua edhe çështja e veprave penale të narkotikëve. U theksua se në rastet e posedimit të narkotikëve, detyrimi për heqje dorë nga përdorimi i drogës nuk është gjithmonë i thjeshtë për t'u aplikuar, veçanërisht kur i pandehuri deklaron se nuk është konsumues dhe gjykata nuk ka prova për përdorim të substancave narkotike. Megjithatë, nga diskutimi rezultoi se edhe në këto raste gjykata duhet ta arsyetojë qartë pse nuk e ka shqiptuar një detyrim të tillë, nëse e ka pasur parasysh mundësinë e shqiptimit të tij. Po ashtu, u theksua se kualifikimi juridik dhe trajtimi

i rasteve të narkotikëve varen nga rrethanat konkrete, sasia e poseduar, provat për shitblerje dhe historiku i mëparshëm i personit.

Përfaqësuesit e gjykatave theksuan se në praktikë ka raste kur detyrimet specifike janë shqiptuar, sidomos për kompensimin e viktimave, kthimin e dobisë pasurore, detyrimet që lidhen me moskonsumimin e substancave narkotike apo alkoolit dhe detyrime të tjera që lidhen me trajtimin apo rehabilitimin. Kjo u theksua veçanërisht në raport me disa aktgjykime të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Gjakovë, të cilat janë përcjellë pas dërgimit të draft-raportit për komente. Megjithatë, u sqarua se këto raste nuk e ndryshojnë metodologjinë dhe gjetjet e mostrës së rastësishme të analizuar, por dëshmojnë se praktika ekziston dhe se ajo mund të zgjerohet më tej.

Një çështje tjetër e ngritur ishte periudha verifikuese në raport me dënimin e shqiptuar. Pjesëmarrësit u pajtuan se rastet kur periudha verifikuese është më e shkurtër se dënimi i shqiptuar janë të palogjikshme dhe problematike, edhe nëse ligji nuk e ndalon shprehimisht një situatë të tillë.

Fokus grupi nxori në pah edhe rëndësinë e trajnimeve. Nga Akademia e Drejtësisë u zotuan se çështja e dënimit me kusht dhe detyrimeve specifike mund të përfshihet në programin e trajnimit të vazhdueshëm për vitin 2027, në kuadër të procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese. Po ashtu, u theksua se kjo temë mund të trajtohet edhe brenda moduleve ekzistuese për sanksionet penale dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Kjo është e rëndësishme pasi problemi nuk lidhet vetëm me njohjen e dispozitave ligjore, por edhe me mënyrën se si ato materializohen në aktgjykime.

Në diskutim u trajtua edhe mundësia që Gjykata Supreme të adresojë këtë çështje përmes diskutimeve të brendshme, udhëzimeve, qarkoreve apo formave të tjera të orientimit të praktikës. U theksua se nuk është domosdoshmërisht e nevojshme të nxirret një udhëzues i veçantë, pasi ekzistojnë udhëzime të përgjithshme për politikën ndëshkimore dhe arsyetimin e vendimeve. Megjithatë, u vlerësua se një orientim më i qartë nga Gjykata Supreme, qoftë edhe përmes diskutimeve të brendshme apo qarkoreve, do të mund t'i sensibilizonte gjykatat për rëndësinë e vlerësimit dhe arsyetimit të detyrimeve specifike.

Në përgjithësi, fokus grupi konfirmoi gjetjen kryesore të raportit se detyrimet specifike me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht aplikohen rrallë dhe se, edhe kur nuk aplikohen, gjykatat zakonisht nuk japin arsyetim të mjaftueshëm. Diskutimi, megjithatë, tregoi edhe se kjo çështje kërkon qasje të balancuar: detyrimet specifike nuk duhet të shqiptohen formalisht apo automatikisht, por duhet të vlerësohen rast pas rasti. Kur ka vend për to, ato duhet të shqiptohen dhe të mbikëqyren në mënyrë efektive. Kur nuk ka vend për to, gjykata duhet ta arsyetojë këtë në aktgjykim. Në këtë mënyrë, dënimi me kusht mund të shërbejë jo vetëm si alternativë ndaj burgimit, por edhe si instrument më efektiv për individualizimin e dënimit, rehabilitimin e kryesit, mbrojtjen e viktimës dhe arritjen e qëllimit të dënimit.

14. Përfundime

- Dënimi me kusht është një ndër dënimet alternative më të rëndësishme në sistemin penal, por efektiviteti i tij varet nga mënyra se si gjykata e individualizon atë në rastin konkret. Nëse shqiptohet pa vlerësim të nevojës për detyrime specifike, ky dënim rrezikon të mbetet vetëm pezullim formal i ekzekutimit të dënimit, që krijon perceptimin e amnistimit të kryerësve të veprave penale.
- Nga 300 aktgjykimet e analizuara, në të cilat janë identifikuar 320 dënime me kusht, gjykatat kanë shqiptuar vetëm 17 detyrime specifike. Kjo përfaqëson nivel shumë të ulët të aplikimit të këtyre detyrimeve dhe tregon se mundësitë që jep Kodi Penal 06/L-074 nuk shfrytëzohen mjaftueshëm në praktikë.
- Vetëm 12 nga 300 aktgjykime kanë përmbajtur detyrime specifike. Kjo tregon se shqiptimi i detyrimeve nuk është pjesë e praktikës gjyqësore me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht.
- Në 288 aktgjykimet ku nuk janë shqiptuar detyrime specifike, gjykatat nuk kanë dhënë asnjë arsyetim për mosçaktimin e tyre. Kjo krijon perceptimin se mundësia e shqiptimit të detyrimeve nuk është shqyrtuar fare dhe se dënimi me kusht është trajtuar kryesisht si vendim formal.
- Edhe në rastet kur detyrimet janë shqiptuar, gjykatat kanë përdorur vetëm një pjesë të kufizuar të detyrimeve të parapara me Kodin Penal. Nga 15 llojet e detyrimeve të mundshme sipas këtij Kodi, në aktgjykimet e analizuara janë aplikuar vetëm gjashtë lloje të tyre.
- Detyrimet specifike nuk janë aplikuar mjaftueshëm as në kategoritë ku ato mund të kenë rëndësi të drejtpërdrejtë, si tek veprat penale kundër pasurisë, narkotikëve, jetës dhe trupit, armëve, sigurisë së përgjithshme dhe korrupsionit zyrtar.
- Mbikëqyrja nga Shërbimi Sprovues është përdorur më shpesh sesa detyrimet specifike, por në shumicën e këtyre rasteve pa u shoqëruar me detyrime konkrete. Kjo e kufizon rolin e mbikëqyrjes dhe e lë atë pa objekt të qartë mbikëqyrës.
- Në dy raste janë evidentuar aktgjykime ku dënimi me kusht ka qenë më i lartë se periudha verifikuese. Edhe pse Kodi Penal nuk e ndalon shprehimisht një praktikë të tillë, ajo është e palogjikshme në raport me natyrën e dënimit me kusht.
- Në përgjithësi, praktika e analizuar tregon se dënimi me kusht në Kosovë shpesh rrezikon të shndërrohet në “kusht pa kushte”: dënim i pezulluar, por pa detyrime konkrete, pa arsyetim për mungesën e tyre dhe pa strukturim të mjaftueshëm të periudhës verifikuese.

15. Rekomandime

- Gjykata Supreme duhet të nxjerrë udhëzues për gjykatat lidhur me vlerësimin dhe arsyetimin e detyrimeve specifike me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht.
- Gjykatat duhet që në çdo rast të dënimit me kusht të vlerësojnë në mënyrë konkrete nëse duhet të caktohen detyrime specifike. Kur detyrimet nuk caktohen, veçanërisht në rastet ku ato mund të jenë relevante sipas natyrës së veprës, gjykatat duhet të japin arsyetim të qartë për këtë.
- Gjykatat duhet ta përdorin më shumë listën e detyrimeve të përcaktuara në Kodin Penal 06/L-074 [neni 56], sidomos në rastet ku detyrimet lidhen drejtpërdrejt me rehabilitimin e kryesit, kompensimin e viktimës, kthimin e dobisë pasurore, parandalimin e përsëritjes së veprës apo mbrojtjen e viktimës.
- Gjykatat duhet të kërkojnë më shpesh raporte nga Shërbimi Sprovues para shqiptimit të dënimit, veçanërisht në rastet kur vlerësimi i rrezikut, nevojave të kryesit ose mundësisë së rehabilitimit është i rëndësishëm për caktimin e dënimit.
- Shërbimi Sprovues duhet të fuqizohet në praktikë si mekanizëm real i mbikëqyrjes, rehabilitimit dhe parandalimit. Mbikëqyrja nga ky shërbim duhet të shoqërohet, kur është e nevojshme, me detyrime konkrete dhe të matshme.
- Akademia e Drejtësisë duhet të zhvillojë trajnime specifike për gjyqtarë dhe prokurorë lidhur me dënimin me kusht, detyrimet specifike, rolin e Shërbimit Sprovues dhe arsyetimin e dënimeve alternative.
- Prokurorët dhe mbrojtësit duhet të jenë më aktivë në propozimin e detyrimeve specifike, veçanërisht në seancat për caktimin e dënimit dhe në rastet e marrëveshjeve për pranimin e fajësisë.
- Gjykatat duhet të shmangin caktimin formal të periudhave verifikuese. Në rastet kur shqiptohet dënim me kusht, periudha e verifikimit çdoherë duhet të jetë më e lartë se dënimi me kusht i shqiptuar.

Aneks 1: Aplikimi i detyrimeve sipas kategorisë dhe veprës penale

Tabela paraqet të dhënat e përmbledhura nga grafikët e raportit për numrin e aktgjykimeve të analizuar dhe numrin e aktgjykimeve ku janë aplikuar detyrimet, të ndara sipas kapitujve dhe veprave penale.

Nr.	Kapitulli / kategoria	Vepra penale	Aktgjykime të analizuar	Aktgjykime me detyrime	% me detyrime
	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Gjithsej për kapitullin	50	7	14.0%
1	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Vjedhja	16	1	6.2%
2	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Vjedhja e shërbimeve	10	2	20.0%
3	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Vjedhja e rëndë	4	0	0%
4	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Grabitja	1	1	100.0%
5	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Shpërdorimi i pasurisë së huaj	3	0	0%
6	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Uzërpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme	3	1	33.3%
7	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë	2	0	0%
8	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Mashtrimi	6	2	33.3%
9	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Keqpërdorimi i besimit	3	0	0%
10	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër	1	0	0%
11	Kapitulli XXVI – Veprat penale kundër pasurisë	Vjedhja e identitetit dhe pajisja e qasjes	1	0	0%
	Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve	Gjithsej për kapitullin	50	3	6.0%
12	Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve	Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge	20	0	0%
13	Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve	Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike	2	0	0%
14	Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve	Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge	27	3	11.1%
15	Kapitulli XXIII – Veprat penale të narkotikëve	Kultivimi i bimës së hashashit, shkurres së kokainës ose bimëve të kanabisit	1	0	0%

Nr.	Kapitulli / kategoria	Vepra penale	Aktgjykime të analizuara	Aktgjykime me detyrime	% me detyrime
	Kapitulli XXVIII – Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	Gjithsej për kapitullin	40	0	0%
16	Kapitulli XXVIII – Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm	18	0	0%
17	Kapitulli XXVIII – Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike	4	0	0%
18	Kapitulli XXVIII – Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës	1	0	0%
19	Kapitulli XXVIII – Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë	Ndërtimi pa leje	17	0	0%
	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Gjithsej për kapitullin	40	0	0%
20	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar	4	0	0%
21	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik	3	0	0%
22	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Konflikti i interesit	2	0	0%
23	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Përvetësimi në detyrë	1	0	0%
24	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Marrja e ryshfetit	1	0	0%
25	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Dhënia e ryshfetit	24	0	0%
26	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Falsifikimi i dokumentit zyrtar	3	0	0%
27	Kapitulli XXXIII – Korrupsioni zyrtar dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare	Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare	2	0	0%
	Kapitulli XXX – Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	Gjithsej për kapitullin	40	1	2.5%
28	Kapitulli XXX – Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	Rrezikimi i trafikut publik	32	0	0%

Nr.	Kapitulli / kategoria	Vepra penale	Aktgjykime të analizuara	Aktgjykime me detyrime	% me detyrime
29	Kapitulli XXX – Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik	Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur	8	1	12.5%
	Kapitulli XVI – Veprat penale kundër jetës dhe trupit	Gjithsej për kapitullin	50	1	2.0%
30	Kapitulli XVI – Veprat penale kundër jetës dhe trupit	Kanosja	14	0	0%
31	Kapitulli XVI – Veprat penale kundër jetës dhe trupit	Ngacmimi	3	1	33.3%
32	Kapitulli XVI – Veprat penale kundër jetës dhe trupit	Ngacmimi seksual	1	0	0%
33	Kapitulli XVI – Veprat penale kundër jetës dhe trupit	Sulmi	5	0	0%
34	Kapitulli XVI – Veprat penale kundër jetës dhe trupit	Lëndimi i lehtë trupor	23	0	0%
35	Kapitulli XVI – Veprat penale kundër jetës dhe trupit	Lëndimi i rëndë trupor	4	0	0%
	Kapitulli XXIX – Veprat penale të armëve	Gjithsej për kapitullin	30	0	0%
36	Kapitulli XXIX – Veprat penale të armëve	Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm	17	0	0%
37	Kapitulli XXIX – Veprat penale të armëve	Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve	12	0	0%
38	Kapitulli XXIX – Veprat penale të armëve	Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse	1	0	0%
	Gjithsej	Të gjitha kategoritë / veprat penale	300	12	4.0%

